

**Raporti i Auditorit të Pavarur
mbi Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012**

“GB-a konstruksion” sh.p.k

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	3
Pasqyra e pozicionit financiar	4-5
Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave	6
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	7
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	8
Shënimet e pasqyrave financiare	9 – 20

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar drejtimit te Shoqerise "G.B-a konstruksion" sh p k

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te Shoqerise **GB-a konstruksion Shpk**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2012, pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit, pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të parimeve bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombetare të Kontabilitetit . Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo e gabimeve; përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël të përshtatshme si dhe kryerjen e vlerësimeve kontabël të përshtatshme për rrethanat.

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Këto standarde, kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit, për vlerat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshi këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive në pasqyrat financiare, qofshin këto si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivetivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2012, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit

Tiranë, Shqipëri

EKSPERTI KONTABEL

Enkeleda Stefani
27 Maj 2013



Shoqeria "GB-a konstruksion" sh.p.k
Bilanci Kontabel me 31 Dhjetor 2012
(shumat ne Leke)

AKTIVET	Shenime	<u>Viti 2012</u>	<u>Viti 2011</u>
AKTIVE AFATSHKURTRA		<u>170,737,037</u>	<u>143,789,991</u>
Aktive monetare	3a	<u>613,938</u>	<u>2,461,231</u>
Banka		575,881	2,434,505
Arka		38,057	26,726
Aktive te tjera financiare afatshkurtra	3b	<u>100,742,072</u>	<u>103,972,305</u>
Kliente per mallra ,produkte e sherbime		97,570,930	97,570,930
Tatim mbi fitimin		1,601,142	4,692,490
Tvsh		-	564,985
Kliente per tu arketuar		1,570,000	1,143,900
Inventari	3c	<u>7,040,353</u>	<u>7,313,781</u>
Lendet e para		3,540,353	7,313,781
Parapagesa per furnizime		3,500,000	-
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		<u>62,340,674</u>	<u>30,042,674</u>
Shpenzime te periudhave te ardhme	3d	62,340,674	30,042,674
AKTIVE AFATGJATA		<u>692,717,592</u>	<u>656,797,058</u>
Investimet financiare afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	4	<u>1,368,026</u>	<u>1,710,828</u>
Makineri dhe pajisje		706,659	856,044
Aktive te tjera afatgjata materiale		661,367	854,784
Aktivet afatgjata jomateriale		27,016	30,018
Aktive te tjera afatgjata		691,322,549	655,056,211
TOTALI I AKTIVEVE		<u>863,454,630</u>	<u>800,587,049</u>



PASIVET DHE KAPITALI

	<u>Viti 2012</u>	<u>Viti 2011</u>
Pasivet Afatshkurtra	608,759,692	571,902,000
Derivativet		
Huamarjet	24,968,990	28,615,903
Overdraftet bankare	24,968,990	28,615,903
3 Huate dhe parapagimet	583,790,702	543,286,097
<i>Te pagueshme ndaj furnitoreve</i>	111,416,387.19	79,810,939
<i>Detyrime per Sigurime Shoqerore Shend</i>	43,098	39,256
<i>Detyrime tatimore per Tap-in</i>	20,300	19,300
<i>Detyrime tatimore per TVSH</i>	151,788	-
<i>(Div per tu pag-hequr)Shuma te arketuara me porosi</i>	472,159,129	463,416,602
Parapagime kliente kreditore	-	-
KAPITALI	254,694,938	228,685,049
Kapitali aksionar	200,940,000	200,940,000
Rezerva Ligjore	17,430,000	17,430,000
Rezerva te tjera		
Fitime te pa shperndara	10,315,049	800,292
Fitim (Humbja) e vitit financiar	26,009,889	9,514,757
<u>TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT</u>	<u>863,454,630</u>	<u>800,587,049</u>



Shoqeria "Gb-a konstruktion" sh.p.k

Llogaria te Ardhura & Shpenzime per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(shumat ne Leke)

		<u>Viti 2012</u>	<u>Viti 2011</u>
Shitjet neto	8	59,566,238	139,539,515
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	9	30,749,500	1,126,800
Materialet e konsumuara	10	28,897,159	96,882,078
Kosto e punes	11	2,877,944	2,918,406
Paga te personelit		2,363,217	2,404,582
Shpenzime per sigurime shoqerore e shendetore		514,727	513,824
Amortizimet dhe zhvleresimet		387,934	490,802
Shpenzime te tjera	12	28,509,947	29,172,390
Totali i shpenzimeve (shumat 4-7)		60,672,983	129,463,676
Fitimi (humbja) nga veprimtarite kryesore(1+2/-3-8)		29,642,755	11,202,639
Te ardhurat dhe shpenzimet financiare	13		
122 Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat		(688,883)	(799,004)
123 Fitimet (Humbjet) nga kursi i kembimit		(7,601)	168,318
Totali i te ardhurave dhe Shpenzimeve financiare		<u>(696,489)</u>	<u>(630,687)</u>
Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)	14	28,946,266	10,571,952
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		2,936,376	(1,057,195)
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		<u>26,009,889</u>	<u>9,514,757</u>
Elementet e pasqyrave te konsoliduara			




Shoqeria "Gb-a konstruksion" sh.p.k
Pasqyra e fluksit te parave - Metoda indirekte
 Periudha kontabel 01 Janar-31 Dhjetor 2012
 (shumat ne Leke)

	<u>VITI 2012</u>	<u>VITI 2011</u>
Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrvtezimit		
Fitimi para tatimit	28,946,266	10,571,952
Rregullime per:		
Amortizimin	387,934	490,802
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme	(29,067,768)	7,442,746
Rritie/renie ne tepricen inventarit	273,428	(856,770)
Rritie/renie ne tepricen e detyrimeve, per t'u paguar nga aktiviteti	36,857,691	45,852,044
Parate e perftuara nga aktivitetet	<u>37,397,551</u>	<u>63,500,774</u>
Interesi i paguar		
Tatimfitimi i paguar	(2,936,376)	(1,057,195)
Fluksi i parave nga veprimtarite investuese	<u>34,461,175</u>	<u>62,443,579</u>
Bleria e shoqerise se kontrolluar X minus parate e arketuara	-	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(36,308,468)	(67,339,530)
Paraja neto, e perdorur ne aktivitetet investuese	<u>(36,308,468)</u>	<u>(67,339,530)</u>
Fluksi i parave nga veprimtarite financiare	-	-
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar	-	-
Te ardhura nga huamarrje afatgjata	-	-
Para neto e verdorur ne aktivitetet financiare	<u>-</u>	<u>-</u>
Rritja/renia neto e mjeteve monetare	<u>(1,847,293)</u>	<u>(4,895,951)</u>
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	2,461,231	7,357,182
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	613,938	2,461,231



Shoqëria "GB- a konstruksion" sh p k*Pasqyra e lëvizjes së kapitaleve të veta me 31 Dhjetor 2011 dhe 2012**(shumat në Leke)*

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore statutore	Fitimi i pashperndare	Totali
Pozicioni me 31 dhjetor 2010	<u>200,940,000</u>	<u>17,430,000</u>	<u>800,292</u>	<u>219,170,292</u>
Fitimi neto per periudhen kontabel			9,514,757	9,514,757
Dividendet e paguar	-	-	-	-
Rritje e rezerves se kapitalit	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve	-	-	-	-
	<hr/>	<hr/>	<hr/>	<hr/>
Pozicioni me 31 dhjetor 2011	<u>200,940,000</u>	<u>17,430,000</u>	<u>10,315,049</u>	<u>228,685,049</u>
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel	-	-	-	-
Prime te kapitalit	-	-	-	-
Fitimi neto per periudhen kontabel	-	-	26,009,889	26,009,889
Dividendet e paguar	-	-	-	-
Rritje e rezerves se kapitalit	-	-	-	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-
	<hr/>	<hr/>	<hr/>	<hr/>
Pozicioni me 31 Dhjetor 2012	<u>200,940,000</u>	<u>17,430,000</u>	<u>36,324,938</u>	<u>254,694,938</u>



1. Te pergjithshme

Shoqeria "GB-a konstrukcion" sh p k eshte themeluar si Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me date 11/11/2003 dhe eshte rregjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tirane me Vendimin Nr 30536 date 13/11/2003. Qe prej 11/11/2003 shoqeria ka nje ortak te vetem, qe eshte Z. Gerti Calliku i cili eshte edhe administrator i shoqerise.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Objekti i shoqerise perfshin ndertim objektesh banimi dhe komplekse turistike etj.

Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambiente e saj. Aktivitet e qendrueshme prone e saj perbehen nga, instalime te pergjitheshme, makineri e paisje pune, paisje informatike, dhe inventar ekonomik.

Kapitali i shoqerise sipas aktit te themelimit ka vleren prej 100 000 leke perbehet nga kontributet Ortakut te Shoqerise dhe perkatesisht:

Z. Gerti Calliku 100% ne Kapital

Numri i punonjesve me date 31 Dhjetor 2012 ka qene 3 (tre)

2. Politikat kryesore kontabile

2.1 Bazat e pergatitjes

Deklarimet financiare te bashkangjitura jane pergatitur ne baze te rregjistrimeve kontabel te mbajtura per qellime te kontabilitetit te vendit konform Ligjit 9228 date 29 Prill 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat Financiare te fund vitit jane paraqitur ne formatin e paraqitur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne fuqi (SKK 2).

Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqiperi deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave Financiare ne perputhje me kerkesat e SKK, kerkon perdorimin e disa vleresimeve kontabile te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe manaxhimi i Shoqerise te jape gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile te saj. Fushat te cilat kerkojne nje shkalle te larte ose komplekse te gjykimit ose ato per te cilat vleresimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekonomike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili perfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar.

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha shqiptare.

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

2.2 Instrumentat financiare

Kompania ka vetem instrumenta financiare jo derivative, perfshire dhe kerkesa nga kliente dhe kerkesa te tjera, mjete likuide dhe te ngjashme me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe te tjera detyrime.

Nje instrument financiar njihet nese kompania eshte pale ne kushtet e kontrates. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat e Kompanise mbi rrejdhat e ardhshme te parase te gjeneruara nga aktivi financiar kane mbaruar ose nese kompania i transferon aktivite financiare nje pale te trete pa mbajtur te drejtat e kontrollit ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet nga aktivi. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohet ne daten e shitblerjes psh. daten ne te cilen kompania vendos vete te bleje apo te shese aktivet. Detyrimet financiare nuk njihen me nese detyrimet e Kompanise e specifikuara ne kontrate mbarojne afatin ose shlyen ose anulohen.

Mjetet Monetare

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e koston se tyre minus provizionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te lejuara mund te llogariten, per shumat e vleresuara si te rikuperueshme, ne fitim humbje kur ekziston nje evidence objektive qe keto kerkesa jane zhvleresuar me pare.

Detyrime te pagueshme

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

Huate bankare dhe te tjera

Ne vazhdim te njohjes fillestare, huate bankare dhe te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur cdo diference midis koston dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv.

Te tjera

Te tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto te amortizueshme duke perdorur metoden e interest efektiv, minus cdo humbje nga zhvleresimi.

Kontabilizimi i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare sqarohet ne piken 2.8.

Aktivitetet financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra pervec rasteve kur kompania ka te drejte te pakushtezuara te ndryshoje marrveshjen e huase per te pakten 12 muaj pas dates se bilancit.

2.3 Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre Shoqeria vlereson inventarin me vleren ne te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten e mbylljes se bilancit. Shuma e Zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ateherë kur ka faktore te ojektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresua.:

2.4 Aktivet Afatgjata Materiale

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Aktivët Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit per ndertesat dhe instalimet teknike eshte metoda lineare e cila merr ne konsiderate jeten e dobishme ekonomike, ndersa amortizimi per AAM te tjera llogaritet mbi bazen metodes zbritese.

Me date 31 Dhjetor 2012 normat e amortizimit te perdorura paraqiten:

Pershkrimi	Norma Amortizimit
Inventar Ekonomik	25 %
Makineri e Pajisje	20 %
Mjete Transporti	20 %

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit percaktohen nga krahasimi i perfitimeve me vleren e tyre kontabel. Keto perfshihen ne pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.

2.5 Aktivet Afatgjata Jo-Materiale

Per vitin 2012 AAJM njihet fillimish me koston qe perbehet nga çmimi i blerjes dhe kosto te tjera qe lidhen drejtperdrejt me blerjen.

AAJM paraqitet ne bilanc me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi

Metoda e llogaritjes se amortizimit eshte metoda lineare ne masen 10 % ne vit.

2.6 Aksionet e kapitalit

Aksionet e tjeshta njihen si kapital. Aksioni njihet me vleren nominale.

2.7 Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabile te aktiveve jofinanciare te Kompanise, pervec inventareve dhe tatimeve te shtyra rishikohen ne cdo date raportimi per te pare nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese ekziston ndonje tregues i tille ateherë vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabile e nje aktivit eshte me e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvleresimi

njihen ne fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e nje aktivi eshte me e madhja mes vleres se tij ne perdorim dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Ne matjen e vleres ne perdorim, flukset e pritshme te parase skontohen ne vleren e aktuale duke perdorur normen e skontimit perpara takses qe paraqet vleresimin e tregut per vleren ne kohe te parase dhe riskun specifik te aktivitetit.

Per humbjet nga zhvleresimi te njohura ne periudhat e meparshme vleresohet ne cdo date raportimi nese ka ndonje tregues sipas te cilit humbja eshte ulur ose nuk ekziston me. Nje humbje nga zhvleresimi anulohet nese kane ndodhur ndryshimet ne vleresimet e bera per percaktimin e vleres se rikuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi anulohet deri ne ate mase qe vlera kontabel e aktiveve te mos kaloje vleren kontabel te aktiveve, minus amortizimin, qe do te ishte peraktuar nese zhvleresimi nuk do te kishite ndodhur.

2.8 Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar zhvleresohet nese ekzistojne tregues sipas te cileve nje ose disa ngjarje kane pasur nje ndikim negativ ne vleresimin e fluksesve te ardhshme te parase prej atij aktivi.

Humbja nga zhvleresimi ne rastin e nje aktivi financiar te vleresuar me kosto te amortizuar llogaritet si diference midis vleres kontabel (neto) dhe Vleres aktuale te fluksesve te pritshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive financiare te nje rendesie te vecante testohen per zhvleresim ne menyre te vecante. Pjesa tjetere e aktiveve vleresohen se bashku, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Humbja nga zhvleresimi mund te anulohet nese ajo mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pasi njohjes se zhvleresimit. Per aktivet financiare te vlersuara ne kosto te amortizuara anulimi i zhvleresimit njihet ne fitim humbje.

2.9 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejte të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjate aktivitetit të zakonshem të Kompanisë.

Te ardhurat përfshijnë shumat neto pa përfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, te cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i pronesisë se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek bleresi.

2.10 Shpenzimet

Shpenzimet

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngakuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

2.11 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet e aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodës se interesit efektiv.

2.12 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet që lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne ditën e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si diference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Kompania njej aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

2.13 Transaksionet me monedhat e huaja

(a) Monedha e perdorur dhe raportuese

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim). Pasqyrat e konsoliduara financiare raportohen ne LEKE shqiptar (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

(b) Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit ne fund te vitit jane :

	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
1 EUR	139.59	138.93
1 USD	105.85	107.54

3. Aktivet Afatshkurtra shoqeria ka ne dispozicion nje shume prej 170,737,038 leke nga te cilat:

- a. *Mjete monetare* perfaqeson Depozita ne banke ne vlere ne arke. Per llogarite ne valute eshte bere azhornimi me kursin e dates 31.12.2012

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Para ne dore	38,057	26,726	11,331
Para ne Banka	575,881	2,434,505	(1,858,624)
Totali	<u>613,938</u>	<u>2,461,231</u>	<u>(1,847,293)</u>

- b. *Aktive te tjera financiare afatshkurter* perfaqeson detyrimet e klienteve per tu arketuar pas dates 31.12.2012 si dhe detyrime te shtetit qe trajtohet ne piken 5.b.

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Kliente per mallra ,produkte e sherbime	97,570,930	97,570,930	0
Te tjere kliente	1,570,000	1,143,900	426,100
Tatim mbi fitimin	1,601,142	4,692,490	(3,091,348)
TVSH	0	564,985	(564,985)
Totali	<u>100,742,072</u>	<u>103,972,305</u>	<u>(3,230,233)</u>

Kliente per mallra produkte e sherbime perfshin veprime te vecanta me shtetin per te ardhura te deklaruar shtetit por te paarketuara ende nga klientet ne vleren 97,570,930.

Kliente te tjere ne vleren 1,570,930 leke perfaqesojne kliente per tu arketuar nga aktiviteti i qeradhenies dhe me 31.12.2012 detajohen si me poshte:

Emri Kompanise	Vlera
2 G shpk	350,000
AEI	340,000
Gb-a studio	530,000
shipvn	350,000
Totali	1,570,000

Tatim nbi fitimin perfaqeson detyrimet e organeve shteterore ndaj shoqerise pas dates 31 Dhjetor 2012.

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Tatim Fitimi	1,601,142	4,692,490	(3,091,348)
TVSH	0	564,985	(564,985)
Totali	1,601,142	5,257,475	(3,656,333.00)

Ne llogaritjen e detyrimeve shoqeria ka mbajtur parasysh kerkesat e Ligjit "Per TVSH", Ligjit "Tatimi mbi te ardhurat" duke i pasqyruar TVSH, tatimin mbi te ardhurat personale si dhe ate ne burim te llogaritur, te regjistruar drejt dhe te papaguar me 31 Dhjetor 2012. FDP me 31.12.2012 kuadron me tepricen e llogarise.

c. *Inventari* ne 3,540,353 leke perfaqeson gjendjen e lendeve te para me 31.12.2012.

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Lendet e para	3,540,353	7,313,781	(3,773,428)
Totali	3,540,353	7,313,781	(3,773,428)

d. *Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra* ne vlere 62,340,674 leke perfaqeson parapagimin e takses se zbardhjes (pjeserisht eshte amortizuar), projekt arkitekturor nga Dea Studio shpk. si dhe shpenzime te tjera te shitjes te kryera per periudhat e ardhme

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Taksa e zbardhjes	8,091,280	8,091,280	0
Projekt arkitekturor	2,450,000	2,450,000	0
Te tjera shpenzime te lidhuara me shitjen	51,799,394	19,501,394	32,298,000
Totali	62,340,674	30,042,674	32,298,000

4. Aktive afatgjata

Aktive afatgjate materiale Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh afatgjate materiale prej 1,368,026.00 leke te detajuara si me poshte:

	Makineri e pajisje	Pajisje zyre dhe informatike	Totali
<i>Aktive te Trupezuara</i>			
Gjendje 01.01.2012	1,882,048.00	2,265,766.00	4,147,814.00
Shtesa	24,645.00	17,485.00	42,130.00
Pakesime	0.00	0	0
Gjendje 31.12.2012	<u>1,906,693.00</u>	<u>2,283,251.00</u>	<u>4,189,944.00</u>
<i>Amortizimi</i>			
Gjendje ne 01.01.2012	1,026,004.00	1,410,982.00	2,436,986.00
Shtesa llogaritur	174,030.00	210,902.00	384,932.00
Pakesime	0.00	0.00	0.00
Gjendje ne 31.12.2012	<u>1,200,034.00</u>	<u>1,621,884.00</u>	<u>2,821,918.00</u>
<i>Vlera neto 01.01.2012</i>	<u>856,044.00</u>	<u>854,784.00</u>	<u>1,710,828.00</u>
<i>Vlera neto 31.12.2012</i>	<u>706,659.00</u>	<u>661,367.00</u>	<u>1,368,026.00</u>

Inventari i aktiveve afatgjate materiale eshte vleresuar me koston e marrjes se tyre. Amortizimi i Aktiveve afatgjate materiale eshte llogaritur sipas normave te vendosura ne piken 2.4 te politikave kontabel.

5. Pasivet Afatshkurter ne vlere 608,759,692 leke, perfaqeson detyrime per t'u paguar pas dates 31.12.2012.

a. *Huamarrjet* perfaqeson huamarrje afatshkurtra per tu paguar pas dates 31.12.2012 dhe detajohen si me poshte :

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Humarrjet afatshkurtra	<u>24,968,990</u>	<u>28,515,303</u>	<u>(3,646,913)</u>
Totali	<u>24,968,990</u>	<u>28,615,903</u>	<u>(3,646,913)</u>

b. Huate dhe parapagimet me 31.12.2012 detajohen si me poshte :

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Te pagueshme ndaj furnitoreve	111,416,388	79,810,939	31,605,449
Detyrime per Sigurime Shoqerore			
Shend	43,098	39,256	3,842
Punonjes	0	0	0
Detyrime tatimore per Tap-in	20,300	19,300	1,000
Detyrime tatimore per Tatim fitimin	0	0	0
Detyrime tatimore per TVSH	151,788	0	151,788
Shuma te arketuara me porosi	472,159,129	463,416,602	8,742,527
Debitore dhe kreditore te tjere	0	0	0
Totali	<u>583,790,702</u>	<u>543,286,097</u>	<u>40,504,606</u>

Furnitoreve per tu paguar pas dates 31.12.2012 dhe detajohen si me poshte:

<u>Emri Korapanise</u>	<u>Shuma</u>
2-Naim Gripshi	2,144,322
AED Color	3,017,868
Agleo shpk	5,598,598
alex vlora	3,299,992
alex profil	1,602,694
Algedi 2008 shpk	11,859,966
AR& det	1,880,000
Arjon shpk	11,512,056
CD group shpk	4,276,004
Duka shpk	7,256,599
Eltec	4,868,251
Euroterm Shpk	885,924
Harif Oshafi shpk	9,001,894
Ikona shpk	18,058,728
Julian Gripsini	2,542,260
Kacorri & 2010	3,744,376
Metal- Plast shpk	1,556,944
Migo Blind Center	1,225,750
Rasim Doci	1,826,160
Roirmar shpk	2,942,999
Tafaruci	2,326,010
Tecno Clipp	4,563,959
Topi E.K.L shpk	4,076,780
Te tjere	1,348,304
TOTALI	<u>111,416,438</u>

Detyrimet sociale:

Llogaritë e sigurimeve shoqërore dhe tatim mbi pagën paraqiten në bilanc me shumën për tu paguar në fund të vitit 2012. Gjate vitit 2012 janë llogaritur dhe shlyer detyrimet për sigurimet shoqërore dhe ato shëndetësore të cilat janë kalkuluar, regjistruar dhe paguar pa pasaktesi.

Detyrimet tatimore

Në llogaritjen e detyrimeve shoqëria ka mbajtur parasysh kërkesat e Ligjit "Për TVSH", Ligjit "Tatimi mbi të ardhurat" duke i pasqyruar TVSH, tatimin mbi të ardhurat personale si dhe ato në burim të llogaritur, të regjistruar drejt dhe të paguar me 31 Dhjetor 2012. FDP me 31.12.2012 kuadron me tepriçen e llogarise.

Shuma të arketuara për porosi pasqyrojnë paradheiet e klienteve gjatë fazës së ndërtimit të objekteve të pa përfunduara akoma

6. Pasivët Afatgjatë nuk ka dhe nuk pasqyrohen në bilanc.

7. Kapitallet e veta me vlerë 254,694,938 leke, janë detajuar sipas zerave:

a. *Kapitali themeltar, Rezerva, Fitimi e Humbje* në të cilat:

Kapitali	200,940,000.00	leke
Rezerva Ligjore	17,430,000.00	leke
Fitimi (humbje) pashpërdare	10,315,049.00	leke
Fitimi i vitit financiar	26,009,889.00	leke

8. Shitjet neto

Shoqëria për vitin 2012 ka realizuar shitje si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Shitje neto nga shërbimet	<u>59,566,238</u>	<u>139,539,515</u>	<u>(79,973,277)</u>
Totali	<u>59,566,238</u>	<u>139,539,515</u>	<u>(79,973,277)</u>

9. Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Shoqëria për vitin 2012 ka realizuar të ardhura të tjera (nga qeradhenia) si dhe të ardhura nga shitje të tjera të patatueshme më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Të ardhura nga qeradhenia	<u>749,500</u>	<u>1,126,800</u>	<u>(377,300)</u>
Të ardhura të tjera	<u>30,000,000</u>	<u>0</u>	<u>30,000,000</u>
Totali	<u>30,749,500</u>	<u>1,126,800</u>	<u>29,622,700</u>

10. Materialet e konsumuara

Ne kete ze perfshihen shpenzimet per blerje e mallrave si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Blerje gjate ushtrimit	25,123,731	97,738,848	(72,615,117)
-Ndryshim i gjendjeve	3,773,428	856,770	2,916,658
Totali	28,897,159	96,882,078	(69,698,459)

11. Shpenzime te personelit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet e pages dhe sigurimet shoqerore si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>Diferenca</u>
Pagat e punonjesve	2,333,217.00	2,404,582.00	(71,365)
Sigurime shoqerore	514,727.00	513,824.00	903
Totali	2,877,944.00	2,918,406.00	(70,462)

12. Shpenzime te tjera nga veprimtari e shfrytezimit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2012</u>
Energji elektrike	387,494.0
Telefon	820,808.00
Furnitura	2,296,647.00
Furniture Vendosje	24,050,110.00
Te ndryshme	295,350.00
Taksa	242,040.00
Totali	28,509,947.00

13. Shpenzime Financiare

Ne kete ze perfshihen te ardhurat dhe shpenzimet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2012</u>
Fitim nga kembime valutore	3,699.00
Te ardhura nga interesat	232.00
Shpenzime interesa	(689,119.00)
Shpenzim nga kembime valutore	(11,301.00)
Totali	<u>(696,489.00)</u>

14. Fitimi i vitit ushtrimor

Fitimi neto llogaritur si me poshte:

	<u>Viti 2012</u>
Fitim Bruto	28,946,266.00
Shpenzime te pa njohura	417,498.00
Baza llogaritjes Tatimit	29,363,764.00
% e tatim Fitimit	10
Shpenzimi i Tatim Fitimi	2,936,376.00

Fitimi i vitit ushtrimor **26,009,890.00**

Per llogaritjen e tatimit mbi fitimin jane marre parasysh shpenzimet e panjohura bazuar ne ligjin "Per tatimin mbi te ardhurat" ne fuqi